

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Intervista në Syri Tv -
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919749/gjithcka-pjese-e-nje-skeme-me-bekimin-e-rames-boci-informacioni-eshte-pushtet/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 15:50:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 15:05:27 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3bf58e71fbd397ead1e5988a515682024964c40d1092ad8744156cf73797b0bb
TEKSTI	cbde64aa1634d698bafd7fa9c28f8873da6d091dec257de82253b4c9a34793bb
PAMJA	b4792b1d635e5a346608d34b7cbe1df277d7c81e15847840610aa8c09635844d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	edf53cbc4efb46efffae7305df72ebef8d5e9947cdabe6ff40062e0c01528bdf9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2a9c3c61cd0a94fc8d628189ad3d77be9fe8dbec0733dde85be2277fcec101e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/edf53cbc4efb46efffae7305df72ebef8d5e9947cdabe6ff40062e0c01528bdf9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px




ÇIM PEÇA

'Nuk e dija, nuk mjafton më'



FATMIR MEDIU

Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk i kundërvu Vuçiçit dhe zgjodhi të flasë për Diellën



më të lexuarat



'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s' menaxhon dot më



'Asnjë hap pas'/ Dita e 120-të e protestave, pankartat: Edi, po të vjen fundi me ndëshkim!




VIDEO/ Balliu: A ka folur Edi Rama me Ergys Agasin përmes telefonit të Vlorë Hysenit?



Epitafi i frikës, apo frika e epitafit?



Berisha: Vlorë Hyseni është kthyer për t'u dhënë restin bashkëpunëtorëve të vet që e tradhtuan



Berisha: Foltoret e Ripërtëritjes në Vlorë dhe Elbasan dëshmuar se orteku i opozitës po rritet çdo ditë



'Gjithçka pjesë e një skeme me bekimin e Ramës', Boçi: Informacioni është pushtet

17:05, 28/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



I ftuar në edicionin e pasdites në Syri TV, deputeti i Partisë Demokratike, Luçiano Boçi, foli për situatën e krijuar rreth Shërbimit Informativ dhe përgjegjësinë e kryeministrit Edi Rama.

Boçi tha se Rama po përpiqet të shmangë përgjegjësinë politike duke ia atribuar përgjegjësinë personave të emëruar dhe drejtuar prej tij.

Deputeti demokrat tha se ajo që po ndodh nuk është thjesht një çështje e transmetimit të informacioneve, por pjesë e një skeme më të gjerë të kontrollit politik.

Boçi deklaroi se Shërbimi Informativ është kthyer në një instrument për interesa politike dhe se informacioni i ka shërbyer kryeministrit edhe përmes kanaleve alternative, përtej komunikimit institucional.

"Pushteti është informacion në demokraci", u shpreh Boçi, duke shtuar se situata kërkon përgjegjësi politike dhe reflektim nga kryeministri.

Pjesë nga intervista:



Si në të gjitha rastet, e dimë që Rama e heq përgjegjësinë e vet dhe mundohet ta çojë te njerëz të cilët ai vetë i ka komanduar, i ka emëruar, i ka urdhëruar dhe mbi bazën e së cilës marrëveshjen me Ramën ata kanë vepruar dhe që ka sjellë këtë lloj situatë sot në Shqipëri, që ka prekur çdo qelizë të shoqërisë, çdo institucion dhe arritur deri tek, kanë thënë, perdja e fundit e sigurisë së një vendi, që është siguria kombëtare, nëpërmjet sigurisë që i takon një institucioni, siç është Shërbimi Informativ.

Që nuk është kaq i thjeshtë për mënyrën si vepron, ekziston sepse fshihet pas tij siguria politike, sociale, ekonomike dhe sot këto siguri, krahas asaj kombëtare, duket që janë të rrëzuara, të rena. Shërbimi Informativ është zbuluar që është një branxh i krimit të organizuar, me bekimin e kryeministrit, i cili në këtë lidhje jo rastësore ka realizuar pushtetin e vet, ka kontrolluar, ka kontrolluar votën e tij dhe ky skandal patjetër që do e çonte në një reagim reflektimi të kryeministrit, largimin e tij, dorëheqje nga detyra, sepse nuk bëhet fjalë vetëm për kalimin e

aisa informacioneve nepermjet Shërbimit Informativ dhe drejtueses se tij nga një grup kriminal në një grup kriminal apo nga një grup ekonomik me interesa të forta ekonomike nga një grup ekonomik.

Gjithçka ka qenë pjesë e një skeme që ka pasur orientimin dhe bekimin e kryeministrit.

Dhe këtu bëhet fjalë për kontrollin politik të situatës në Shqipëri.

Ju kujtohet Edi Rama kur thoshte: "Jam dy-tre hapa para jush", që bërtiste në Parlament, dhe ai njeri që është dy-tre hapa është njeriu që ka informacionin. Pushteti është informacion në demokraci dhe ky informacion i vinte kryeministrit nga rruga alternative, jo thjeshta nga ai zarfi që dorëzohet çdo mëngjes në mënyrë institucionale nga Shërbimi Informativ në Kryeministri dhe Presidencë, por nga rruga e koordinatorit të tij.

© SYRI.net

Lexo edhe:



'Nuk ka kthim pas!'/ 121 ditë protesta, qytetarët kërkojnë dorëheqjen e Edi Ramës



Belshi refuzon shkrimin me Elbasanin, PD voton kundër, PS abstenon në Këshill



Tabaku: Shqipëria nuk vuan nga 'republika e prokurorëve', por nga republika e të korruptuarve

Fjalimi i turpshëm në OKB/ Berisha: Rama, armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër VV-së

'Mos kujtoni se ju kam vjedhur'/ Këlliçi-Ramës: Je kreu i narkoshtetit dhe kryehajduti i shqiptarëve, jep menjëherë dorëheqjen

'Zullumi po e kap për fyti Ramën', Noka në Tepelenë: Skandalet e kanë zhveshur totalisht

TË NGJASHME



Kur Rama prek themelet e 'familjes' europiane



Këshilli i Sigurisë Kombëtare, Logu: Aty më shumë ishin mbledhur çunat e Gysit me çunat e Ronit...



Kampi në Gjadër/ Italisë i kushtoi 50 mln euro menaxhimi i strukturave në 2025! Ja sa emigrantë po strehohen



Neveriteni diarrenë mediatike të Ramës, e gjithë goditja tek Kayo, Gysi, Roni dhe Vlora!



Bardhi takon Ambasadoren e re të Holandës në Shqipëri: Krimi dhe korrupsioni kanë kapur shtetin



SYRI TV/ Begaj mbledh këshillin e Sigurisë Kombëtare, asnjë diskutim për kompromentimin e SHISH! U! Ramën përballë Spahos



Përplasja e gardistëve të Ramës me gazetaren Ambrozia Meta/ AGSH: S'mund t'i mohohet aksesit për pyetje

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.